



# BULETINI

Qershor 2011

Numër 6/2011

## Përmbajtja

**1. Aktivitetet nga Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor (PVAL)**

**2. Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve për Avancim (PTA)**

**3. Aktivitetet nga Programin Fillestar për Arsimim Ligjor (PFAL)**

**ZHVILLIM  
PRFE-  
SIONAL GJY-  
QËSOR**

Adresa: Lagja e Spitalit, Rr.  
"Muharrem Fejza" pa.nr.  
Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel&fax: +381 (0) 38 512 069  
+381 (0) 38 512 081 +381 (0) 38  
512 095 www.kjijudicial.org  
info@kjijudicial.org

## ***Aktivitetet nga Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor (PVAL)***

### **Seminar, civile Shpronësimi IGJK– OSCE**



- Dallojnë rastet kur mund të jetë organ shpronësues Komuna e kur Qeveria;
- Identifikojnë faktin se objekt i shpronësimit mund të jenë të drejtat pronësore private dhe të drejtat pronësore të një komune ose të një autoriteti komunal;
- Listojnë subjektet e procesit të shpronësimit, vendimet që dalin nga ky proces;

Përcaktojnë mënyrat e kompensimit dhe transparencën e kësaj procedure.

Çështjet të cilat janë përfshirë gjatë këtij sesioni kryesisht kanë pasur të bëjnë me risitë e Ligjit mbi Shpronësimi, i cili është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 26 mars 2009 dhe është shpallur nga Presidenti më 23 prill 2009.

Më 01 qershor 2011, IGJK në bashkëpunim me OSBE-në, Misioni në Kosovë, në kuadër të Programit të Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor ka realizuar sesionin e radhës me temë: "Ligji për Shpronësimin".

Qëllimi i këtij trajnimi ishte krijimi i praktikave më të reja dhe funksionale në procesin e shpronësimit dhe zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore në zgjidhjen e kontesteve për shpronësimin.

Objektivë kryesorë ishte që pjesëmarrësit pas përfundimit të këtij trajnimi të:

- Zbatojnë drejt rrjedhën e procedurës së shpronësimit;
- Dallojnë rolin e organit shpronësues dhe veprimet përgatitore;

Në kuadër të kësaj në fokus kanë qenë procesi i shpronësimit duke filluar nga organi shpronësues, qëllimi i ligjshëm publik, mos diskriminimi, subjektet e kësaj procedure, vendimet preliminare dhe vendimet përfundimtare, kompensimi dhe mënyrat e kompensimit, ankesat dhe trajtimi i tyre, transferimi i kompetencave për shpronësim dhe bashkëpunimi me grupet e interesit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e lëmisë civile të nivelit komunal, qarkut dhe nivelit suprem.

## Tryezë pune Zhvillimi i Shkathtësive të Përfaqësimit gjatë Gjykimit IGJK-NITA



Më 7, 8 dhe 9 qershor 2011, IGJK në bashkëpunim me Departamentin e Drejtësisë së SHBA -ve-Programi OPDAT dhe Institutin Kombëtar të Avokimit gjatë Gjykimit (NITA) nga SHBA-të.

Qëllimi kryesor i këtyre trajnimeve ishte që pas përfundimit të tij pjesëmarrësit të jenë në gjendje të përdorin teknikat më të avancuara të përfaqësimit të rasteve gjatë gjykimit.

Çështjet të cilat janë përfshirë gjatë këtyre sesioneve trajnuese kryesisht kishin të bënin me teknikat e marrjes në pyetje të drejtperdrejtë, të tërthortë, vënia në dyshim, rimarrja në pyetje e të pandehurve, dëshmitarëve, ekspertëve, si dhe teknikat e paraqitjes së fjalës hyrëse dhe argumentimit përfundimtar, si nga ana e prokurorit ashtu edhe nga ana e avokatit mbrojtës.

Gjatë këtyre trajnimeve pjesëmarrësve iu mundësua që përmes punës në grupe të demonstrojnë shkathtësitë e tyre të përfaqësimit gjatë gjykimit, duke punuar rreth një rasti praktik dhe duke përdorur teknikat e prezantuara nga trajnuesit vendor të trajnuar posaçërisht për këtë trajnim.

Gjithashtu, të gjitha prezantimet e pjesëmarrësve janë incizuar, me qëllim të marrjes së sugjerimeve dhe udhëzimeve për paraqitjen e tyre.

Në fund të trajnimit pjesëmarrësve u janë shpërndarë certifikatat për përfundimin me sukses të trajnimit. Përfitues të këtyre trajnimeve ishin gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha nivelet dhe regjionet e Kosovës.

## Tryezë e diskutimesh Procedura përgatitore për të mitur IGJK-UNICEF

Më 14 qershor 2011, IGJK ka realizuar sesionin trajnues nga lëmia penale për të mitur me temë “Procedura Përgatitore për të Mitur”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte analizimi i çështjeve që kanë të bëjnë me procedurën përgatitore si; fillimi dhe pushimi i procedurës përgatitore, roli i prokurorit dhe gjyqtarit për të mitur, roli i organit të kujdestarisë dhe Shërbimit Sprovues në procedurën përgatitore si dhe rastet kur mund pushohet procedura përgatitore.

Në tryezë u trajtuan çështjet problematike që shfaqen në praktikë nga këndvështrimi profesional i gjyqtarëve, prokurorëve dhe të tjerëve, me qëllim të unifikimit të zbatimit të dispozitave ligjore që e rregullojnë procedurën përgatitore për të mitur.



Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë, zyrtarë nga Policia e Kosovës, organi i kujdestarisë dhe Shërbimi Sprovues i Kosovës.

## A7-Civile: E drejta Evropiane ne praktikë: Hyrje dhe Përqendrim në të drejtën civile IGJK -Twinning

Më 20 deri më 24 qershor 2011, IGJK në bashkëpunim me Programin e Binjakëzimit-Reformimi i Sistemit të Arsimit Ligjor në Kosovë, ka realizuar një kurs pesëditor trajnimi me temën e theksuar më lartë.

Në përmbajtje të këtij trajnimi në mënyrë të gjithanshme u trajtuan çështjet lidhur me të Drejtën Evropiane, historia e sajë, struktura organizative e Bashkimit Evropian, lidhja në mes të së Drejtës Evropiane dhe KEDNJ-së si dhe roli i Gjykatës së Drejtësisë.

Objektivë e këtij trajnimi ishte që në të ardhmen pjesëmarrësit të jenë në gjendje të:

- Interpretojnë nocionin e “Bashkimit Evropian”, “Këshillit të Evropës dhe Këshillit Evropian”.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e lëmis civile dhe gjyqtarët për kundërvajtje nga të gjitha regjionet e Kosovës.

- Kuptojnë rolin e Gjykatës Evropiane e Drejtësisë në Luksemburg.



- Shpjegojnë rolin dhe funksionin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg.
- Bëjnë dallimet në mes GJED-së në Luksemburg dhe GJEDNJ-së në Strasburg.
- Interpretojnë burimet ligjore të Bashkimit Evropian dhe ndikimet rregulloreve dhe direktivave evropiane në ligjet vendore (nacionale). Demonstronjë raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në Luksemburg.

### Tryezë pune në lëmin civile “Kontratat Komerçiale”

Më 28 qershor 2011, IGJK në bashkëpunim me Programin për Sistemin e Përmbartimit të Marrëveshjeve dhe Vendimeve (SEAD) i mbështetur nga Misioni USAID, organizoi tryezën e punës me temë “Kontratat Komerçiale”.

Vëmendja kryesore gjatë kësaj tryeze u përqendrua në avancimin e njohurive lidhur me zbatimin efikas të dispozitave ligjore në fuqi lidhur me kontratën e licencës, lizingut, kontrollit të mallit dhe magazinimit.

Rëndësia e këtij trajnimi konsiston në atë se gjyqtarët pas përfundimit të tij do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë kornizën e përgjithshme ligjore në fuqi për kontratën e licencës, lizingut, kontrollit të mallit dhe magazinimit;

- Shpjegojnë dispozitat e Ligjit për Lizingun dhe Ligjit për Detyrimet lidhur me kontratën e licencës, lizingut, kontrollit të mallit dhe magazinimit;

- Dallojnë elementët kryesore të kontrata për licencën, lizingun, kontrollin e mallit dhe magazinimit;

- Shpjegojnë përgjegjësin për dëmin të kontrata për licencën, lizingun, kontrollin e mallit dhe magazinimit;

- Shpjegojnë efektet juridike të kontratës për licencën, lizingun, kontrollit të mallit dhe magazinimit si dhe të kuptojnë mënyrat e shuarjes së këtyre kontratave;

Përfitues të kësaj tryeze ishin gjyqtarë të lëmis civile nga të gjitha regjionet e Kosovës.

## 2. Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve për Avancim (PTA)

### Moduli: Akti Administrativ dhe Konflikti Administrativ - PTA

Më 15 qershor 2011, IGJK në kuadër të Programit të Trajnimeve për Avancim realizoi sesionin e radhës me temë “Akti Administrativ dhe Konflikti Administrativ”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zbatimi i drejtë i dispozitave të Ligjit të Procedurës Administrative dhe Ligjit për Konfliktin Administrativ.

Objektivë kryesore e këtij trajnimi ishte: njohja me aktet administrative, identifikimi i akteve relativisht të pavlefshme dhe absolutisht të pavlefshme, identifikimi i elementeve që duhet ti përmbajë një akt administrativ dhe aktet administrative kundër të cilave mund të zhvillohet konflikti administrativ.

Çështjet të cilat janë përfshirë gjatë këtij sesioni, kishin të bëjnë kryesisht me aktet administrative dhe llojet e tyre, pavlefshmërinë e akteve administrative,



konfliktin administrativ dhe risitë e Ligjit mbi Konfliktin Administrativ.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarët nga Gjykatat Komunale kryesisht të lëmisë civile dhe Gjykatat për Kundërvajtje nga gjitha regjionet e Kosovës

### Trajnim i Avancuar për Gjyqtarët Porotë



Më 22 qershor 2011, IGJK në kuadër të aktiviteteve trajnuese realizoi një sesion të karakterit regjional të veçantë për gjyqtarët porotë. Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve porotë me rastin e vendosjes së rasteve praktike në gjykatë dhe ngritja e reputacionit dhe pozitës së tyre.

Objektivë kryesore ishte që gjyqtarët porotë pas përfundimit të këtij trajnimi të jenë në gjendje që të:

- Kuptojnë rolin e tyre me rastin e vendosjes në praktikë të çështjeve statusore;
- Dallojnë rolin e tyre në kuadër të trupit gjykues për të mitur dhe në atë për të rritur; Njohin sjelljen e mirë dhe të pahijshme në bazë të parimeve dhe rregullave të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtarë Porotë.

Çështjet të cilat janë diskutuar gjatë trajnimit kryesisht kishin të bëjnë me rolin e gjyqtarëve porotë në zbatimin e ligjit mbi familjen, rolin e gjyqtarëve porotë në seancat gjyqësore për të rritur dhe të mitur si dhe etika e sjelljes së gjyqtarëve porotë.

Gjithashtu atyre iu mundësua që përmes një rasti praktik të demonstrojnë shkathtësitë e tyre në identifikimin e shkeljeve etike të paraqitura.

Përfitues ishin gjyqtarët porotë të regjionit të Prishtinës, Gjilanit dhe të Mitrovicës.

### **3. Aktivitetet nga Programin Fillestar për Arsimim Ligjor ( PFAL)**

#### **Trajnimet e PFAL III**

Gjatë muajit qershor 2011 kanë vazhduar trajnimet për fazën e tretë të gjeneratës së tretë të kandidatëve në Programin Fillestar për Arsimim Ligjor.

Pasi që trajnimet e fazës e dytë kanë përfunduar, kandidatët iu janë nënshtruar provimit më 6, 8 dhe 10 qershor.

Kandidatët iu janë nënshtruar provimeve në të gjitha modulet në të cilat kanë ndjekur trajnimet gjatë periudhës 3 (tre) mujore.

Administrimi i provimit është bërë sipas rregullave të Provimit Përgatitor duke iu përshtatur specifikave të provimeve në PFAL.

Administrimi i provimit është monitoruar nga vëzhgues ndërkombëtarë të OSBE-së.

Vlerësimi i provimit është bërë gjatë muajit qershor, ku të gjithë trajnuesit që kanë hartuar provimin kanë bërë vlerësimin në mënyrë anonime duke vlerësuar vetëm numrat sekret të provimit pa ditur se i cilit kandidat është provimi.

Përveç se iu kanë nënshtruar provimeve për fazën e dytë të PFAL, kandidatët kanë ndjekur trajnimet praktike nën mbikëqyrjen e Mentorit gjyqtarë apo prokurorë, sipas programit të përcaktuar nga IGJK në koordinim me Koordinatorët e Mentorëve.

Këto trajnime janë ndjekur nga 32 kandidatë.

#### **Takim me Koordinatorët e Mentorëve PFAL III**

Me qëllim të vlerësimit të punës së Mentorëve dhe ndikimi i trajnimeve praktike tek kandidatët, më 15 qershor 2011 është mbajtur një takim ndërmjet Koordinatorëve të Mentorëve dhe kandidatëve të PFAL III.

Në këtë takim Koordinatorët u interesuan për metodologjinë e punës së Mentorëve me kandidatë dhe zbatimin planit të punës për fazën e tretë.

Në këtë takim kandidatët prezantuan mënyrën dhe kushtet e trajnimit të cilat iu janë ofruar nga gjykatat dhe prokuroritë, e posaçërisht mbështetja që kanë gjetur tek Mentorët.

Të gjithë kandidatët vlerësuan me notë të lartë trajnimin praktik dhe përfundimisht u konstatua se kjo periudhë trajnime është shumë e dobishme në përgatitjen dhe aftësimin e tyre profesional në mënyrë që ata të jenë në gjendje të ushtrojnë funksionin e gjyqtarit apo prokurorit në mënyrë shumë profesionale që nga dita e parë e punës në këtë detyrë.

## Trajnimet në PFAL – gjenerata IV

Trajnimet në fazën e parë të PFAL - gjenerata IV kanë vazhduar edhe gjatë muajit qershor sipas orarit dhe programit trajnues.

Kandidatët janë duke ndjekur trajnimet intensive (6 ditë në javë), ku tri ditë ndjekin trajnimet në IGJK, ndërsa 3 ditë tjera janë në gjykata përkatësisht prokurori varësisht nga profili për të ndjekur trajnimet praktike. Trajnimet janë duke i ndjekur 57 kandidatë.



## Konferenca e parë vjetore e të diplomuarve në IGJK



Më 25 qershor 2011, IGJK për herë të parë organizoi një konferencë vjetore për kandidatët e diplomuar të gjeneratës parë dhe të dytë të PFAL.

Gjatë kësaj konference janë diskutuar çështje shumë të rëndësishme të tilla si; lidershipi, hartimi dhe arsyetimi i mirë i opinioneve ligjore, etika, përvojat gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit dhe prokurorit, sfidat dhe zgjidhjet adekuate.

Pjesëmarrësit patën mundësinë për të adresuar çështjet që ata kanë në punën e tyre të përditshme në gjykata dhe prokurori. Një panel i prokurorëve dhe gjyqtarëve në mesin e të cilëve edhe Kryetari i Gjykatës Supreme u ishte përgjigjur pyetjeve të vijuesve.

Përkushtimi i IGJK-së për suksesin e kësaj konference u demonstrua edhe me mundësinë për vlerësimin e të dy programeve trajnuese (PFAL dhe PVAL) e cila u bë duke angazhuar pjesëmarrësit në plotësimin e një pyetësori nëpërmjet të cilit ata patën mundësinë të vlerësojnë dhe japin rekomandimet për zhvillim të mëtejshëm të programeve trajnuese të IGJK-së.

Në konferencë morën pjesë kandidatët e gjeneratës së parë dhe të dytë të PFAL të cilët tani ushtrojnë funksionin e gjyqtarit apo prokurorit.